REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 27.02.2026 Prot.52 (pesëdhejtëedy)

Protokoll nr. 52

I mbajtur sot më datë 27.02.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 08.01.2026.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin janar 2025";
5.P-V "Për dhënie ndihme financaire për familje në nevojë"
6.P-V "Për ndarjen e planit të bursave nga fondi i bashkisë për vitin shkollor 2025-2026";
7. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.M.S banues në Fshatin Zvezdë Nj.A Pojan, banesa e të cilit u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
8.P-V "Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Maliq për vitin 2026";
9. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2 datë, 08.01.2026 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminsitratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";
10.P-V "Për miratimin e Raportit të III-të Monitorimit të Buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2025";
11-P-V "Për miratimin e kërkesës për transferimin dhe ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa pronave nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Maliq";
12-P-V "Për mbledhjen e taksave vendore ndëpërmjet agjentit tatimor";
13.P-V "Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinacim dhe listës së përfituesve, të projektit "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara viti 2026";
14.P-V "Për miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Maliq 2026-2028";
15.P-V "Për miratimin e Rregullores së brendshme për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës në bashkinë Maliq.
16.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari;Idlir Limllari; Fevri Sherifi; Pranvera Begolli; Enida Avdolli; Petrit Kupe; Danjela Ibrahim; Gentiana Drabo;Floreta Zaçe; Aramando Dautllari; Marinathi Avrami; Klea Baçi;Dritan Çami;Selami Muço; Kristina Malelli; Ilia Xhuti; Xhuana Hoxhallari; Faslli Zholi; Yllson Ibrahimllari; Server Xhuti; Neresida Shindo; Dalina Krekas; 22(njëzetëenjë) këshilltarë.

Mungesa: Plator Çollaku; Andonaq Risto; Rovena Terolli; Albina Xhejo; Eglantina Balli; Eriseld Jonusllari; Marjeta Xhelollari; Lulëzim Hoxhaj; Almir Elezi; 9 (nentë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka;Sekretare e Përgjithshme:znj.Jonila Xhialli; Drejtori i Pronave Publike dhe Asteve:z.Johand Sula; Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti;Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta.

Ornildi Demollari:Përshëndetje!Në pa mundësi shëndetësore për të drejtuar mbledhjen e Këshillit, kryesimin e mbeldhjes po ja le zv/Kryetarit të Këshillit znj.Endia Avdolli.

Enida Avdolli:Përshëndetje të gjithëve, fillojmë mbledhjen e radhës së këshillit. Së pari, verifikojmë korumin me nëntëmbëdhjetë këshilltarë në sallë. Korumi verifikohet. Ah, ! Me rendin e ditës, ne jemi njohur paraprakisht. Ju ftoj që të miratojmë rendin e ditës, por tek rendi i ditës kemi edhe një shtesë, të cilën mund ta shtojmë tek pika të ndryshme. Dhe shtesën e keni marrë sot, në lidhje me fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit zgjerimi i varrezave publike në fshatin Vashtmi Bashkia Maliq. Atëherë, jeni dakord të miratohet rendi i ditës, duke shtuar tek pika të ndryshme edhe këtë pikë?
21 vota por.
Kundër s'ka.
Abstenim, Nuk ka. Rendi i ditës, miratohet. pika e dytë është konflikti i interesit, pika e tretë është miratimi i procesverbaleve të dy mbledhjeve të kaluara, që janë përkatësisht mbledhjet e datave 30.01.2026 dhe mbledhja e dates 08.01.2026. E miratojmë procesverbalin e këtyre mbledhjeve?
21 vota pro.
Kundër? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka, miratohet për të dy procesverbalet. Tani do doja që në rendin e ditës të kalonim tek pika tetë, sigurisht me miratimin tuaj të kalonim tek pika tetë dhe nëntë, që janë dy pika në lidhje me buxhetin e bashkisë. Jemi dakord që të diskutohen së pari këto dy pika. Atëherë, pika tetë për miratimin e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzetë e gjashtë. Komisioni i financave ka diçka për të shtuar.

Petrit Kupe:Në takimin që u organizua me kryetarin, këto dy pika janë mjaft të rëndësishme, veç atyre që janë parashikuar në këtë projekt mendim, u diskutuam edhe për disa ndryshime, të

cilat kanë të bëjnë dhe me buxhetin dhe me nivelin e pagave. Buxheti i bashkisë në këtë vit në këtë periudhë shtohet për njëqind e katërmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë lekë. Këto janë si rezultat i rekordimit të rezultatit financiar të vitit 2025, për mos hyrë në thellësi. Shtohet në zërat përkatës të buxhetit, njëkohësisht parashikohet edhe balancimi i kryetarëve që sigurohen nga ky rekordim, me shpenzime që do të kryen për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Parashikimet janë menduar të kryejnë atje ku janë më të domosdoshme, nga ana e financës, nga ana e kryetarit të bashkisë. Por menduam që këtu, në këtë buxhet, të propozuam dhe ramë dakord në komision, bëhen disa ndryshime. Që kanë të bëjnë me forcimin e mëtejshëm të buxhetit dhe një nga ato ndryshime mendohesh që të shtohen shpenzimet për investime në asfaltime. Për fondin e asfaltimit të shtrirë në tre vitet e ardhshme, mendoj që këto të shtohen nga në vlerën mbi dhjetë milionë lekë për çdo vit. Megjithatë, më saktësisht do të interpretojë edhe kryetari, duke patur parasysh gjendjen e përmbytjes të këtij viti. Siç e dini, nuk do hyjnë hollësira për demet e shkaktuara në kultura bujqësore. Apo gjetkë këto ditë ka dalë në, ka dalë në pah dëmtimet e shkaktuara në rrugët e parcelave të Bashkisë Maliqit. Kryesisht edhe atë të fushës Drithasit, të gjitha rrugët e parcelave janë bërë të pakalueshme. Edhe ato të shtruara më parë, po dhe ato të tjera të pashtruara si rezultat i nxirjes së prodhimit në kushte të vështira të motit. Edhe menduam që fondi që ka të bëjë me transportin e çakllit apo blerjen e çakllit për këtë vit të shtohet në një vlerë prej 50 milionë lekë. Është një investim i domosdoshëm. I cili do të shërbejë riparimit të dëmeve të konsiderueshme nga përmbytjet? Kjo shtesë do të bëhet brenda buxhetit të bordit të kullimit, për të cilin ranë dakord, këto ishin disa nga propozimet që ndryshimet që mund të bëhen në këtë shtesë të buxhetit, kjo është një shtesë e konsiderueshme, e cila flet për forcim të buxhetit të bashkisë Maliqit, për më shumë investime dhe për më shumë shërbime në komunitet. Këto kishin një si komision.

Enida Avdolli: Faleminderit, kemi diçka tjetër për të shtuar. Ta kalojmë? Po, po, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Pavarësisht se jeni i njohur me materialin, është një material i rëndësishëm edhe për ne si organ ekzekutiv. Ne jemi munduar të mbulojmë një sërë shpenzimesh në proces, shpenzime apo fatura të prapambetura të palikuiduara. Të cilat ja u kemi pasqyruar edhe në regjistrin shtesë të bashkisë sipas strukturave buxhetore. Në shpenzime operative, detyrime në shpenzime operative të reja në zërin, gjashtëqind e gjashtë, gjashtëqind e katër, siç janë hartim projektesh, dyqind e tridhjetë, dyqind e tridhjetë e një, edhe investime, investime edhe si detyrime dhe investime të reja. Ne kemi parashikuar një fond për rehabilitimin e shkollës sovjanit me rreth dhjetë milionë lekë të reja. Kemi një fond për rehabilitim të terrenës sportive 2.4 milionë. Kemi parashikuar një fond prej tre 290 mijë lekë për blerje aparat analizash për qendrën shëndetësore Maliq, blerje kamerash për shkollat. Ju kemi prezantuar edhe një blerje të një aparati tjetër grirës për mbeturinat e gjelbra në territor, pasi duhet të kemi një makinë stacionere dhe një lëvizëse në të gjithë territorin e bashkisë për të bërë të mundur eliminimin e mbetjeve urbane në territor për efekt të përmirësimit të pastrimit. Blerje kasaforta, blerje orë qyteti, blerje fikse zjarri, ndërtim objekt turizmi. Dhe këtu dua të citoj, duam të krijojmë një objekt. Dhe për këtë i kam propozuar edhe komisionit të financës, po ju propozoj edhe ju t'i bëjmë një shtesë rreth dyqind e pesëdhjetë mijë lekë, i cili do ta heqim nga fondi i oponencës

brenda aparatit. Dhe për t'ia shtuar këtij zëri, pasi vlera shkon pak më lart. Sistemim asfaltim rrugë njësi administrative me pesëqind e pesë mijë lekë po të marrim këtu në konsideratë edhe objektet trevjeçare, edhe me komisionin kemi rënë dakord që mund të bëjmë një shtesë fondi për këtë qëllim. Sistemim asfaltim rrugë njësitë administrative, fondi i performancës 4.4 milionë lekë. Shtesë për fonde makine elektrike, blerje pajisje për kaldajat, rehabilitim vepra ujore 4.5 milionë lekë. Këtu menduam të bëjmë një ndryshim që të heqim tre milionë lekë këtu dhe t'ia shtojmë fondit për çakëll rrugësh dhe çakëlli nga tre vete katër pikë pesë. Me idenë që jo se duam të dëmtojmë fondet e bordit të kullimit për këtë qëllim, po duke qenë që fondet e emergjencës ende nuk na kanë ardhur. Dhe nga informacioni që unë kam, ato na dyfishohen për këtë vit. Themi që aty mund të mbulojmë fonde që kanë të bëjnë me emergjencat civile, pasi Ministria e Mbrojtjes këtë vit ka zbatuar një formulë të re të. Të shpërndarjes së fondeve të emergjencave, jo në bazë të popullsisë, se sa në bazë të risqeve që ka çdo bashki në territor. Dhe në këtë këtë diferencë, të cilën po e pumojmë çik tani në këtë moment.Këto ishin propozimet që folëm me komisionin. Patëm disa debate të vogla, të themi për disa paga në lidhje me teknikët e në njësitë administrative. Dakord, po meqë e mora fjalën, atëherë ram dakord që të bëjmë njësim të disa pagave, edhe pse ne kemi bërë rregullimin e mundshëm pothuajse të gjithë pagave, për të mos patur një njësim edhe midis drejtuesve dhe punonjësve. Por ndoshta duhet diskutuar pastaj në pikën nëntë, e cila mbyllet kjo si procedurë. Jemi munduar të përfshijmë të gjitha fondet specifike, të cilat janë sipas strukturave buxhetore. Fondet e arsimit shkojnë tek arsimi të shërbimit zjarrfikës. Edhe aty kishim një fond të konsiderueshëm për rehabilitimin e godinës shërbimit zjarrfikës dhe ngritjen e një ofiçine të themi për këtë shërbim. Pasi duam të krijojmë edhe aty kushtet më të mira për këta punonjës, të cilët e kanë të domosdoshme, pasi kanë një shërbim një shërnim 24 orë, për këtë lloj shërbimi janë fonde po të shërbimit zjarrfikës. Të gjitha fondet janë mbuluar sipas strukturave buxhetore që ato përmbledhin. Shumë faleminderit.

Enida Avdolli: Atëherë kalojmë në votim pikën tetë. Kush është dakord? 21 vota pro.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka, pika tetë miratohet. Kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak numër dy të datës tetë të parë të dy mijë e njëzet e gjashtë, për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë.

Pranvera Begolli:Përshëndetje, komisioni i financës. Kryetari e përmëndi dhe pak më përpara e kaloi atë. Aktualisht, si studiovi ra në propozim për ndryshimin e disa pozicioneve të punës në drejtimin e pagave, që do ta shikojë kryetari si dakord.

Enida Avdolli: Mendoj që Petriti kishte diçka për të shtuar. Po.

Petrit Kupe: Dhe ky projektim është në kuadër të asaj që u premtua në dhjetor për ruajtjen e proporcionalitetit të pagave si rezultat i rritjes që u bë në muajin dhjetor, për profesione të rëndësishme, të cilat barazoheshin në të padrejtën, dhe për rregullimin e specialiteteve në këto paga. Për çdo rritje pagë, mendojmë se është një hap i rëndësishëm pozitiv që i shërben. I shërben punonjësve, i shërben familjet e tyre, kështu që ne pa të njëjtën mënyrë kategorike jemi dakord që kjo rritje të miratohet. Ajo që më bie në sy në këtë projektim është vlerësimi i pagës të punonjësve të bashkisë. Që janë specialistë, përveçanërisht vlerësimi i pagës së punonjësve që kanë bërë me bordin e kullimit. Në këtë situatë të vështirë të përmbytjeve ose të zjarreve janë dy

nga sektorët më të rëndësishëm që i kanë përballuar në kohë dhe në rezultate, gjithë këto vështirësi ku ofrësohen, vlerësohen punonjësit që kanë bërë me mjetet skravatorë, të cilët me gjithë mend kanë bërë një punë të lavdërueshme deri në deri në. Edhe në sakrifica të ditës së punës në kohë të vështira e tjera, gjithashtu është përvlerësuar edhe rritja e pagave që bëhet sektorit të zjarrëfikseve, të cilët kanë përballuar këto vështirësi të zjarreve apo të katastrofave. Mbledhjes i bashkohet dhe z.Yllson Ibrahimllari, shkon në 22 numri i Këshilltarve të pranishëm sallë. Kështu që ne jemi dakord që këto ky nivel pagash të rritet, bashkë me ato disa ndryshime që propozuam për disa korrigjime të vogla. Dhe jemi dakord, miratohet.

Enida Avdolli: Faleminderit, diskutime të tjera në lidhje me këtë pikë. Dakord, ta kalojmë në votim atëherë? 21 vota pro.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim Nuk ka, pika nëntë miratohet. Atëherë vazhdojmë me pikën katër të rendit të ditës, që është projekt vendim për miratimin e ndihmës ekonome.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mua mund të më jepni leje, pasi jam në gjendje gripale. Almën e kini këtu, drejtoreshën e financës, që mund t'ju shërbejë për probleme që kanë të bëjnë me financë apo me problemet. Shumë faleminderit këshillit.

Enida Avdolli: Faleminderit atëherë rikthehemi tek pika katër e rendit të ditës.Për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin janar dy mijë e njëzetë e pesë, kemi diskutime në lidhje me këtë pikë. Po, Faslli.

Faslli Zholi: Përshëndetje të gjithëve, ne i pamë në komisionin e ndihmave ekonomike. Me komentat, jam dakord të ftoj sallën ta votoj me ndihmat ekonomike.

Enida Avdolli: Atëherë ta kalojmë në votim? 21 vota por.

Abstenim? Nuk ka.

Kundër një votë.(Yllson Ibrahimllari)Miratohet pika katër e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën pesë të rendit të ditës për dhënie ndihmë financiare të familjeve në nevojë. Jeni njohur me projektvendimin? Kemi ndonjë diskutim në lidhje me këtë pikë? Ndonjë koment, diçka për të diskutuar?

Faslli Zholi: Edhe këtë ne e diskutuam edhe me ekzekutivin.Jam dakord që të ndihmohen ato familje, të cilat kanë nevojë shumë. Faleminderit.

Enida Avdolli:E kalojmë në votim atëherë pikën pesë? 21 vota pro.

Kundër? Një vote.(Yllosn Ibrahmllari)

Abstenim? nuk ka. Miratohet pika pesë e rendit të ditës. Vazhdoimë me pikën gjashtë, projekt vendim për ndarjen e planit të bursave nga fondi i Bashkisë për vitin shkollor dy mijë e njëzet e pesë, dy mijë e njëzet e gjashtë. Diskutime rreth kësaj pike, komisioni i përkatës, nëse ka ndonjë.

Nerseida Shindo:Përshëndetje, nuk kemi diçka për të diskutuar konkretisht. Unë isha kurioze për ndërrimin e pozicionit të kariges apo të kryetarit në nënkryetar. Jo, kurioze thashë për kuriozitetin tim.

Enida Avdolli:E kalojmë në votim atëherë pikën gjashtë të rendit të ditës? 21 vota pro.

Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.miratohet edhe pika gjashtë dhe vazhdoi me pikën shtatë të rendit të ditës. Projektvendim për dhënie ndihme financiare për familjen e zotit me inicialet mësë, banues në fshatin Zvezdë, njësia administrative Pojan, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit.Kemi diçka për të diskutuar për këtë pikë, ta kalojmë në votim.
Yllson Ibrahimllari:Të paktën të dëgjojmë një fjalë të komisionit.
Enida Avdolli: Po, patjetër.

Yllson Ibrahimllari: Sepse kam parë që s'ka shumë vlerësues vërdallë, s'ka specialistë që të bëjnë vlerësime, dhe ne kalojmë gjithnjë me karton. Komisioni kryetari këtu është të na i thotë.
Enida Avdolli: Atëherë komisioni.

Yllson Ibrahimllari: Komisioni s'është mbledhur dhe ne i kemi bërë të gjitha, ose është mbledhur dhe unë s'kam qenë prezent. Ta thotë vetë zoti Tani, e kemi bërë procedurë këtë dhe unë besoj që ata sektori i përkatës nuk i ka aftësitë e nevojshme për të bërë vlerësime të tilla. Ne do ta kalojmë pro, sepse ajo familje ka fatkeqësi, por duhet thelluar një çik më shumë. Mos na vijnë nga dy lavatriçe, nga tre televizorë, pesë frigoriferë. Faleminderit. Dakord, atëherë, japim fjalën Zotit Stilian Belishta.

Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta:Përshëndetje të gjithëve, atëherë është pikë së pari lidhja me rënien e zjarrit në banesën e Zotit Muhamer Sali në fshatin Zvezdë, Njësi administrative Pojan. Grupet e punës në zbatim të urdhërit të kryetarit të bashkisë kanë bërë vlerësimet, të cilat i gjeni në praktikën bashkëlidhur në dokumentacion. Është e rrugës, mendoj që nga ana e këshilltarëve, qoftë të mazhorancës, po qoftë edhe të opozitës. Të bëhen vlerësime dhe qëndrime objektive me argumenta konkrete lidhur me situatat e vlerësimit dhe jo të jepen opinione.Se sa ka aftësinë apo nuk ka aftësinë profesionale apo dhe ligjore dhe teknike, sektori përkatës në rastin konkret, duhet të kuptojnë që vlerësimet nuk bëhen nga sektori, vlerësimet bëhen nga grupet e punës specifike të ngritura për këtë qëllim. Nuk e përcakton këshilli i bashkisë apo këshilltari që ky grup është apo nuk është i aftë për ta bërë këtë punë. Nëse ka pyetje të tjera, unë di që shpitë kanë lavatriçe dhe ne nuk mund të vlerësojmë aty bomba atomike, sepse bomba atomike zakonisht kanë lavatriçe. Dhe ligji nuk e përcakton në qoftë se ka një lavatriçe, dy apo dhe shtatëmbëdhjetë lavatriçe. Pra, mund të mos ketë televizor dhe mund të ketë tre lavatriçe. Kjo është ajo që neve, pra grupet e punës, konstatojnë në fakt. Në qoftë se ka ndonjë qëndrim tjetër me argumenta teknikë dhe ligjorë, jemi të gatshëm që t'ju japim shpjegimet tona respektive dhe përkatëse mbi përcaktimet e ligjit, njëqind e dyzet e pesë, dy mijë e nëntëmbëdhjetë për mbrojtjen civile dhe këmës treqind e njëzet e nëntë, dy mijë e dymbëdhjetë për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dëmeve në aspektin imobilar dhe në aspektin ndërtimor. Faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit, atëherë kemi diçka tjetër për të shtuar, përpara se ta kalojmë, po zoti Ildir.

Idlir Limllari: Përshëndetje në këtë pikë, desha të diskutoja që nuk është e drejtë të sapo tha, sapo dëgjuam që ne mund të shkojmë sa lavatriçe ka ndonjë objekt. Se edhe unë mund t'ia vë zjarrin në shtëpi, se të fut nja dhjetë lavatriçe aty.Edhe ti marrë bashkisë një dhjetë lavatëriçe, kjo duhet të jetë. Do të bërë një rregullore, a nuk e di unë, se nuk mund të kalohet kështu, domethënë me tre lavatriçe apo me katër lavatriçe. Po.

Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta: Bashkohem me shqetësimin e këshilltarit, por realisht duhet një rregullor dhe duhet një procedurë më e sofistikuar, më e përditësuar. Por këto janë mangësitë e ligjit njëqind e dyzet e pesë dy mijë e nëntëmbëdhjetë për mbrojtjen civile. Ku citohet në pikën e tij që me miratimin e këtij ligji, jo më vonë se dy vjet duhet të dalin akte nënligjore që burojnë nga ky ligj për të bërë këtë procedurë vlerësimi. Dhe mangësia që ekziston në këtë rast është që ne ke Ky është një shqetësim që është ngritur nga ne, nga bashkia dhe nga aktorë të tjerë, por që akoma është në fazën e ndërtimit të një VKM-je me procedurat konkrete, sepse si duhet të bëhet ky vlerësim. Ligji i vërtetë tregon se çfarë duhet të bëjmë, por nuk tregon rrugën se si duhet ta bëjmë këtë punë në mënyrë specifike. S'ka udhëzim përkatës.

Enida Avdolli: Faleminderit. Atëherë, edhe një herë kemi diçka tjetër.

Yllson Ibrahimllari: Kemi diçka këtë që sapo mbajti zotëria si përgjegjës, do ta mbaj te komisioni i këshillit që është përcaktues për këtë dhe është vetë komisioni i këtij këshilli, i cili paraqet relacionin këshillit. Faleminderit.

Enida Avdolli: Atëherë, ju lutem, pak më seriozitet në lidhje me komisionet. Të bëhet mbledhja e komisioneve sipas përcaktimit, edhe në materialet e dërguara.

Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta: Po. Patjetër, qëndrimi i këshilltarit të kryetarit të grupit opozitar është real dhe duhet që komisioni, jo vetëm për këtë rast, por për gjitha rastet duhet të mblidhet dhe unë duhet të jem prezent në rastin konkret. Unë jam dhe me leje, por sot kam erdhur për këtë qëllim. Nuk jam thirrur nga komisioni për këtë çështje.

Enida Avdolli: Faleminderit atëherë, duke kërkuar nga komisioni që për raste të tjera të ngjashme të mblidhet në kohën e duhur. Mund ta kalojmë në votim? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Kemi një abstenim. (Ildir Limllari) miratohet. Vazhdojmë tani me pikën dhjetë të rendit të ditës për miratimin e raportit të tretë të monitorimit të buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Kemi ndonjë koment nga këshilli përpara se t'ia japim fjalën drejtoreshës së financës.
Petrit Kupe: Është paraprakisht një raport që kryhet në mënyrë periodike mbi treguesin e monitorimit në çdo fazë, të cilën e kemi kaluar si gjithmonë. Më e hollësishme të më thënë në këtë shefje financë.

Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka:Përshëndetje të gjithëve. Është një detyrë ligjore, Ligji i Financave Vendore, numër gjashtëdhjetë e tetë, dy mijë e shtatëmbëdhjetë, përcakton raportin e monitorimit çdo katër mujor. Ky që po miratojmë sot është i katër mujorit të tretë të vitit dy mijë e njëzet e pesë. Për periudhën shtator-dhjetor dy mijë e njëzet e pesë, të gjitha janë në treguesit financiar-ekonomik të aktivitetit të bashkisë. Është raporti sipas tabelave që i keni njohur të gjithë dhe tregon realizimin e buxhetit, shpenzimet, të ardhurat. Dhe mangësitë që kemi në gjatë të vitit 2025 për realizimin një, jo mangësi, por një defekt që është në atë buxhet, është mosrealizimi i të ardhurave. Kjo ndikon në edhe mosrealizimin e të gjitha shpenzimeve që miratojmë për, sidomos për investimet, të cilat u trashëguan për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë, që të bëhet likuidimi. Kjo është brenda afateve, siç për çdo vit, çdo katër mujor i parë dhe i dytë miratohen. Një muaj në muajin pasardhës, këtë katër mujor i fundit është dy muaj, i cili do të dërgohet edhe në Ministrinë e Financave. Tani po të ketë ndonjë pyetje,

Enida Avdolli: Faleminderit, kemi pyetje, kemi diçka për të diskutuar. Mund ta kalojmë në Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.Projektvendimi i numër njëmbëdhjetë, numër dhjetë miratohet, dhe kalojmë tek projektvendimi numër njëmbëdhjetë për miratimin e kërkesës për transferimin dhe ndryshimin e përgjegjësisë në administrimin e disa pronave nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Maliq. Kemi diçka për të diskutuar.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula;Ka nevojë, po patjetër, përshëndetje të gjithëve, siç jeni njohur dhe në material. Ky është një projekt i cili ka qenë shqyrtuar para disa vitesh, por duke qenë se Ministria e Mbrojtjes në atë periudhë, siç duket, nuk e ka shprehur dakordësinë, sepse i ka pasur akoma në inventaret e tyre. Nuk e ka dhënë dhe kishte mbetur e patrajtuar nga ana jonë, nga kontakti i fundit që kemi marrë edhe me Ministrinë e Mbrojtjes. Ata janë dakord që nga ajo listë inventari që ne kishim, me përjashtim të dy objekteve që ishin në fshatin Pocestë, që ata po bëjnë ndërtime.Pjesa tjetër të kalojnë, dhe konkretisht kemi në fshatin Lozhan dy pasuri që na kalohen një në Plovisht dhe një në Sovjan, gjithsej bëhen katër pasuri të ish-Ministrisë të Mbrojtjes. Që kalojnë në përgjegjësi administrimit të bashkisë dhe janë objekte që janë aktualisht shumë të përdorshme dhe do na vijnë në ndihmë për për t'i përdorur dhe nga ana e bashkisë.

Enida Avdolli: Faleminderit, po doktor.

Yllson Ibrahimllari:Ju lutem, kemi një raport të gjendjes ekzistuese të këtyre objekteve dhe cila është vlera e tyre në marrje. Jo në transferim, çfarë gjëndje fizike kanë dhe sa janë të vlerësuar nga një auditor? Faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit, po.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Atëherë dua të sqaroj që vlerësimi është bërë vetëm nga ana e konstruksionit të jashtëm.Përsa i përket vlerës apo vlerësimeve të

tjera, nuk u janë bërë objekteve. Është bërë vetëm vlerësim vlerësim viziv. Dhe me dokumentacionin që ata disponojnë, kaq.

Enida Avdolli: Faleminderit, pyetje tjetër kemi?

Petrit Kupe:Këto objekte, mos janë të abandonuara apo janë të zaptuara? Nuk e di çfarë gjendje janë.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Objektet aktualisht janë që i kanë njësitë administrative nën mbikëqyrje të dy, edhe në fshatin Lozhan dhe në fshatin Plovisht. Dhe në Sovjan i kanë pasur njësitë administrative. Dikush kujdeset për to, por aktualisht janë objekte funksionale, domethënë nuk janë të rrënuar. Janë objekte ekzistues.

Yllson Ibrahimllari:Dhe kur kemi kaluar organigramën e kësaj bashkie, të kaluar në mbledhjet e janarit, nuk kemi pasur asnjë funksionar ose në listë ndonjë person që të ishte përgjegjës pranë njësive administrative përkatëse për këto objekte. Këto objekte janë. Siç thoshte një profesor i jotë dhe imi, kur vajti një herë në Kubë, erdhën ata kubanezët këtu për të vizituar Pasha Limanin. Edhe tha, ne tani kemi dalë nudo, tha, nuk kemi probleme më për të treguar sekretet tona kombëtare. Ato objekte s'kanë asnjë roje, asnjë inventarizim. Biles, për fatin e keq, ju është prishur edhe gardhi. Faleminderit.

Enida Avdolli:Për këtë pjesë, ndoshta do duheshe kryetari për të dhënë më tepër sqarime, ose.

Faslli Zholi: Desha të shtoja diçka.Tashi unë desha të shtoj diçka në këto objektet ushtarake, se shumë më pak i dimë edhe ku janë dhe ku ndodhen gjendjen që kanë. Më bëhet qejfi dhe është pozitive që e merr bëhet zot bashkia për këtë ndërtesa, të cilat kanë qenë të kostueshme, kanë qenë shumë të leverdishme për komunitetin apo Ministrinë e mbrojtjes së për Shqipërinë në tërësi. Dua të them që është e drejtë ajo që thotë edhe doktori dikush aty, që janë pa inventarë, janë shkatruar besoj që me këtë që do të bëjmë, të vihet dorë, të paktën të ruhen, të administrohen dhe të bëhet një dokument. Gjendja si është faktike dhe ç'herë mund të, sepse ato depot e Lozhanit nuk duhet të humbasim. Edhe nuk duhet të shkatërrohen, se do të na duhen edhe neve si komunitet. Po do të na duhet edhe më tej. Faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit, atëherë mund ta kalojmë në votim? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. miratohet dhe projektvendimi njëmbëdhjetë. Kalojmë tek pika dymbëdhjetë e rendit të ditës, projektvendim për mbledhjen e taksave vendore nëpërmjet agjentit tatimor. Atëherë komisioni.
Petrit Kupe:Për këtë projektvendim është bërë dhe janë bërë dëgjesa në njësitë përkatëse administrative dhe në bashkinë e Maliqit. Është një projektvendim mjaft i rëndësishëm për mendimin tim, tepër i vonuar. Bashkitë e tjera, këtë metodë të vjeljes së taksave kanë vite që e kanë realizuar. Ndërsa Bashkia e Maliqit në vitin e dymbëdhjetë po mundohet që ta kalojnë

nëpërmjet agjentit tatimor. Kjo mënyrë vjelje ka mjaft përparësi në mënyrën ekzistuese të vjeljes së tatimit të taksave vendore. E para, një që ka efektivitet në rritjen e të ardhurave. Në përqindje mendoj edhe të konsiderueshme, por ajo që ka prapë përsëri rëndësi. Nuk duhet të jetë një numër kaq i madh i punonjësve që mbledhen me tatim taksat, mbasi një pjesë e mirë e këtyre aboneteve do të kalojnë nëpërmjet Agjenti tatimor, për të cilin bashkia do të paguajë edhe një tarifë përkatëse, varet nga kontrata që dhuron shkruhet. Kjo metodë është metodë, mendoj unë, mjaft e rëndësishme dhe e kohës. Nuk është tepër arkaike ajo metoda që ndjekim sot, duke vajtur derë më derë. Apo duke zënë në rrugë nga punonjësit taksave si ata taksa mbledhësit në kohën e zogut, është një metodë mjaft e vjetër. Njëkohësisht, kam përjetuar edhe vetë në njësitë administrative, kur edhe unë dhe kushdo që vete, banorët, priten jo me përshëndetje, po priten a i ke paguar taksat. Është një metodë që duhet të eliminohet, megjithatë. Kjo praktikë që do të zhvillohet nuk përfshin të gjithë numrin e abonentëve që janë numri e familjeve të cilat kanë detyrime taksa vendore, mbasi ujësjellësi, ujësjellësi ka,janë vetëm dhjetë mijë e pesëdhjetë mijë e pesëqind familje që kanë kontratë me ujësjellësit.Kështu që një pjesë përsëri e konsiderueshme, e familjeve ngelen të vilën me metodën e vjetër, me atë të trokiturit derë më derë apo të bërjes së presionit. Unë do të isha, nuk e di se a funksionon një agjent më të mirë në mbledhjen e taksave, do të ishte OSHE-ja. Sepse nuk besoj se ka familje pa kontratë energjie. Ka familje pa kontratë, ku i pishëm për shumë arsye, po familje pa kontratë energjie nuk ka. Kjo do të ndikonte, besoj, që të mblidheshin pothuajse mbi nëntëdhjetë përqind të taksave lokale nga agjentë tatimorë, patjetër që kjo metodë kërkon edhe një. Kërkon edhe një menaxhim të mirë nga drejtoria e taksave, mbasi Bashkia Maliqi nuk e ka këtë eksperiencë për mënyrën e transferimit të faturimit të taksave dhe për mënyrën e shkarkimit të taksave të mbledhura. Megjithatë, ka një praktikë dhe bashkia e Maliqit më mësoi shumë vjen nga bashkia e Korçës, si funksionon ky proces për të bërë të mundur. Këto efekte pozitive që do të patjetër që edhe ajo shkurtimi numër punonjës do të shërbejë në forcimin e buxhetit të bashkisë. Këto kisha.

Enida Avdolli: Faleminderit, po kemi dhe diçka për të shtuar.

Faslli Zholi: Tashti, me këtë projektvendim.Ne e diskutuam edhe në kryesi dhe shumë mirë u bë që u bë me dëgjesat, por unë kam disa rezerva për të thënë. Në lidhje me dëgjesat e qytetarëve, por në radhë të parë e kam me këshilltarët që jemi këtu në sallë të dy krahëve, që të bëhet një dëgjesë dhe ta udhëheqë këshilli i bashkisë me komunitetin dhe të mos marrin pjesë këshilltarët. Nuk them një arsye e fortë, po më nuk ka këshilltarë. Unë mora pjesë në disa, jo në të tëra, se edhe ne kishim punë dhe disa qytetarë më thoshin, se s'na lajmëruat. E them këtë herë që kur badigjesa duhet të kemi parasysh të gjithë të zgjedhurit, qoftë edhe administrata, qoftë administratorët, qoftë edhe ekzekutivi, mos mjaftohen vetëm me një njoftim që mund të na bëjnë nëpër rrjetet sociale. Po të gjenden format që të marrin vërtetë emrin dëgjës popullore, ashtu siç bëjmë. Kur dalim për fushatë, që mos i përzihej punët, unë isha di edhe si nënkryetar me prefekten.Në një takim dhe doli problemi, edhe një komision që e kaluam atë pikë, që nuk mblidhen komisionet. Edhe disa gjëra të tjera midis tyre, dhe këto dëgjegjësat duhet patur shumë parasysh. Dhe jam dakord tani këtë agjentin që kanë përzgjedhur bashkia ekzekutive të ujit apo të OSHE-së. Është në dorën e tyre ta zgjedhin si u bëhet më mirë. Por ka disa modalitete që ne i diskutuam edhe në dëgjësat. Cilat janë këto? Ka shumë familje të cilat nuk kanë kontratë me ujësjellësin. Ka shumë familje nëpër rrugë. Rrugën nëpër ambiente që nuk kanë paguar taksat,

tashi këtu fillon një hendek.Cili është hendeku? Kur ky paguan rregullisht taksat, sepse shteti apo bashkia, çdo njeri funksionon me taksa. Dhe kjo është duhet të bëhet edukatë në çdo familje, në çdo të zgjedhur të punohet që taksat duhet t'i paguajmë, t'i japim dhe t'i marrim, sepse kjo e thamë edhe për të gjithë dhe kudo rrit dhe interesin, rrit dhe të ardhurat e bashkisë nëpërmjet disiplinës më mirë. Dhe bëjmë një rrugë më shumë, bëjmë një kanalizim më mirë. Shtrojmë një rrugë. E di që janë tokat, janë copë-copë rrugët, nuk vete dot as me zetor, jo me mjet. Prandaj, unë jam dakord që kjo punë të zgjidhet dhe të instalohet nëpërmjet agjentit, qoftë me OSHE-në, qoftë me ujësjellësin. Kjo është në dorën e ekzekutivit, ku i kanë ato të bëjnë kontratën dhe duhet përcaktuar disa modalitete. Taksa kur paguhet te vjet, do të paguhet të sqarohen një se njerëzit e dinë. Është qind mijë lekë, për shembull, taksa plus edhe ujin. E i duket, duhet përpjesëtuar. Nuk ka rritje taksash, duhet thënë kjo se ka shumë rëndësi. Kjo duhet sqaruar, duhet sqaruar. Për shembull, a ka ndonjë modalitet tjetër?Për shembull, dikush e mbyll të gjithë, siç paguajnë disa oferta telefoni. Kur e mbyll brenda njëherësh, këtë shumë mirë i bëhet edhe dikasteri, ku edhe individit po çfarë për ta stimuluar që kjo të funksionojë dhe të rritet përqindja. Pastaj, me ata që janë debitorë, duhet parë me kujdes, se ka dhe nga ata që i kanë mundësi dhe nuk kanë paguar. Nuk kanë pyetur fare për shtet. Po ka ndonjë hallexhi, pastaj ë Faleminderit.

Enida Avdolli: Atëherë kemi diçka tjetër për të shtuar ose plotësuar. Kemi diçka nga Drejtoria e Financave.Diçka nga përfaqësuesi i bashkisë.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhialli:Përshëndetje të gjithëve.Këtu kemi edhe përfaqësuesit e Drejtorisë së të ardhurave, por gjithsesi për një sqarim më të detajuar, meqënëse kam qenë edhe pjesë e takimeve në konsultimet publike që kemi bërë në të gjitha njësitë administrative, ashtu edhe tek Bashkia Qendër. Pothuajse shumica e vetë banorëve dakordësonin për këtë hap që ka marrë Bashkia për kalimin e taksës nëpërmjet agjentit tatimor. Kjo ishte diçka pozitive do të gjenerojë më tepër të ardhura, do të ulë nivelin e debitorëve dhe në këtë mënyrë do të rritet edhe shërbimi ndaj qytetarëve. Shuma totale që do të ketë çdo person për të paguar taksa vjetore që ka në vit, ajo do të përpjesëtohet në dymbëdhjetë muaj brenda faturës së ujësjellësit apo OSSHE, me kë do të vendosim marrëveshjen në fund. Pra, do të ulet, do të ulet barra duke paguar çdo muaj një masë të caktuar të taksës, e cila në qoftë se mbledh në dymbëdhjetë muaj bën totalin. Ndërsa pjesa tjetër, të cilët nuk janë të mbuluar me kontrata ujësjellësi, ata do të ndiqen nga drejtoria e të ardhurave, ashtu sikurse kemi vazhduar deri më sot. Faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit.Atëherë mund ta kalojmë në votim, apo kemi diçka për të shtuar? E kalojmë në votim?20 vota pro.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet dhe pika dymbëdhjetë e rendit të ditës. Dhe kalojmë tek pika trembëdhjetë për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim dhe listës së përfituesve të projektit, përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuara për vitin dy mijë e njëzetë e gjashtë. Atëherë, kryetari i komisionit të strehimit, kemi ndonjë sqarim?

Idlir Limllari:Është është krijuar grupi punës për miratimin e në parim të përmirësimit të banesave ekzistuese, komitetet e varfra janë bërë në bazë të njësive administrative përzgjedhja. Sipas komisionit, tashmë janë gati gjashtëdhjetë e dy familje, të cilat përfitojnë një shumë të përbashkët, afërsisht gjashtëdhjetë milionë lekë të reja. Këto do të kalojnë në përmirësimin e çative në muret mbajtëse.Ky investim është tetëdhjetë përqind i qeverisë, njëzetë përqind është i

bashkisë me ligj. Sa janë listat?Besoj që të jem përzgjedhur. Unë nja dy që i njoh unë. Janë familje të varfra. Nuk mund t'i njoh të gjithë, po që Ishallah, vitin tjetër kemi më pak. Jemi dakord që të miratohet.

Enida Avdolli: Faleminderit. Kemi të tjera komente? Po.

Yllson Ibrahimllari:Duke falenderuar kryetarin e komisionit përkatës të këshillit dhe anëtarët e komisionit për gjithë ekspozenë që bënë, unë mendoj që t'i servirim këtij këshilli një listë me 38 përfitues. Në një njësi gjeografike administrative, në të cilën ne paguajmë ose për skema përfituese e ndihmës ekonomike shtetërore, plus dhe personat që ne miratojmë çdo muaj gjashtë për qindëshin, të kemi vetëm tridhjetë e tetë persona përfitues. Më duket një shifër goxha e ulët. , okej, dhe gjashtëdhjetë e dy në tre mijë veta, të cilët kanë. Kanë marrë ndihmë ekonomike shumë e ulët. Atëherë, problemi qëndron edhe në seleksionin e tyre. Unë mendoj që ne si këshillë. Përpara se sa të vazhdojmë, një iniciativë e mirë ishte në kohën kur filluat dhe bëtë. Bëri ekzekutivi një një pjesë tjetër. Për shembull, ja këtu në tërë listën. Unë nuk besoj që Gora dhe Moglica të ketë këtë nivel ekonomik që asnjëri mos ketë nevojë, kur gjithë shpitë janë mbuluar me llamarinë dhe hyjnë dhe shiu brënda, po për të mos e bërë më shumë sesa për mos i kaluar nivelin teknik të problemit, mendoj që ne duhet të shikojmë bashkë me ekzekutivin mundësinë e regjistrimit. Meqë te taksat, Zoti Kupë shkoi deri te koha e zogut, paktën të rrinim tek koha e Enverit. Që të paktën të ishin inventarizuar banesat nëpër fshatra, është një problem goxha i madh. Nuk përfitojnë dot as në momentin kur dëmtohen, nuk përfitojnë dot as nga tërmeti. Nuk ka lista, nuk kanë tapi, nuk kanë hipotekim. Dhe bashkia i ka këto mundësi me njësitë administrative të ngrejë grupet e punës. T'i sqarojë për rrugën juridike që shumë mirë e kishte filluar zyra e zotit Sulo, por të paktën të ketë një inventarizim, se edhe nëse i themi ca gjëra ne këtu bashkë me juve, problemi qëndron përpara ndarjes së re territoriale.Të paktën mos i çojmë andej matanë nga njësitë ku do shpërndahen pa i inventarizuar. Unë duhet të dini, ju e dini vetë. Besoj që edhe në Libonik duhet të ketë e nderuar doktoreshë. Por besoj që në të paktën në dy zonat që po flas për njësinë administrative Moglicë dhe njësinë administrative Gorë, askush nuk ka asnjë tapi shtëpie. Ju faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit. Kemi diçka për të shtuar ose sqaruar nga përfaqësuesi i ekzekutivit.

Petrit Kupe: Kam unë diçka para se të. Edhe nuk ka rëndësi, sepse ç'a krahu jemi, por në mbështetje dhe të fjalës doktorit. Ndoshta kam qenë pak i bezdisur, por gjithmonë kam ngritur problemin si do bëhet me familjet që s'kanë çertifikat pronësie. Këto familje që s'kanë çështje nga pronësia janë shumë herë më të dobët nga ato që ne po e bëjmë fshatit sot. Dakord, kemi biseduar për një rrugë tjetër, kemi biseduar për një rrugë tjetër bashkë me kryetarin. Që të gjendet mundësia e një praktike tjetër me fondet e bashkisë të përballonit. Deri tani nuk kemi asnjë shenjë, nuk kemi asnjë përpjekje që të vihet në vijë. Nuk kemi ja këtu, se i dha vetëm këto që kanë çertifikatë pronësie dhe për të cilat edhe unë kam kontestimin tim personal dhe nuk do ta miratoj. Për këtë arsye, do dalë kundra. Në qoftë se nuk vihet në rrugë ky procesi i ndihmës së familjeve më të vobekta, ne e kohë që bëjmë edhe nga ata që janë disa herë më mirë, çatitë, mirë bëjmë që i bëjmë. Po kjo gjëja duhet zgjidhjet, jemi duhet të jemi solidarë. Njërit ngjitur ia bëjmë çatinë, se ka çertifikatën. Tjetri që është më keq, e lëmë t'i pikojë çatia. Ku është këtu? Ku është

iniciativa? Ku është kriteret? Ku është bashkia? Ku janë fondet? Pse nuk veprohet kështu që unë jam kundër?

Faslli Zholi: Unë jam plotësisht dakord me parafolësin. E shikoj që këta familje marrin dy goditje. Goditja e parë që nuk po gjejnë dot dermanë për të dokumentuar atë banesë që kanë. Dhe goditja tjetër është që nuk iu afrohet dot, sepse përjashtohet nga kriteret që nuk kanë dhe nuk ka faj iks. Ne kërkuam që të gjejmë edhe me ekzekutim me kryetarin. E diskutuam. Falenderoj zoti Kupe. Që thamë që çfarë do të gjejmë një rrugë që të paktën atë njëzet përqindëshin që investon bashkia të ndërhyjë tek këta, ashtu si e ka dhe, ne këtu kemi një problem të cilët mendojnë që duhet ta zgjidhin. Dhe se si do ta zgjidhim, hajt ta vendosim atë që na takon ligji dhe rregullorja. Por kjo punë duhet të marrë një drejtim. Faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit, atëherë mund të dëgjojmë pak Zotin Ledion, ju lutem.

Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli:Përshëndetje? Së pari, dua të nis me pjesën e zonës së Gorës dhe Moglicës, me shqetësimin që ngriti këshilltari. Dhe ne e kemi këtë shqetësim, sepse në ajo zonë nuk kemi patur kërkesa për aplikim për përmirësimin e banesave. Për vetë faktin sepse ajo zonë nuk e di, se nuk është se jam shumë i informuar, por nga kërkesa që na kanë ardhur, kanë qenë vetëm dy-tre këto dy vitet e fundit që ne ato i kemi përfshirë në project, kanë patur me amtp. Për pjesën e kontratës së që të kontratës, më falni, për pjesën e çertifikatës së pronësisë. Ministria, duke qenë se e di këtë problem, është e informuar shumë mirë që sidomos familjet e varfra dhe këto kategori familjesh nuk kanë dokumenta pronësie të abdetuara, si çertifikatë pronësie ose leja legalizimi, të tilla atëherë ka bërë një lëshim të cilin ka futur në si dokument të vlefshëm amëtëpenë zero njëshin dhe listën e trojeve. Dhe në një pjesë nga këto familje që janë të përfshira në këtë projekt dhe në projektin e viteve të kaluara, kemi përfshirë familje me çertifikat pronësie, me leja legalizimi dhe me t Amëtëpë zero njësh, kush është i informuar për pjesën e dokumentacionit që mbajnë njësitë administrative? Dokumentacion i vjetër, por ky ka një kusht tjetër. Në rast se është me amëtëpë zero njësh listë rojesh, duhet që familja që banon në banesë të ketë përbërjen e saj familjare me pronarin në vitin e nxjerrjes së amëtëpësë në nëntëdhjetë e njësh. Në rast se nuk figuron në çertifikatën e nëntëdhjetë e njëshit, atëherë pavarësisht se ka Amtëë nga ai babai ta themi, nuk përfiton, sepse nuk ka qenë pjesëtar në të. Në familjen e në trungun familjar në vitin nëntëdhjetë e një, domethënë ky këto kushte, janë të vendosura nga financuesi, i cili është Ministria e Ekonomisë, dhe nuk janë të vendosura nga ne. Tani ne kemi biseduar edhe me zotin Fazlli para disa ditësh. Kemi bërë një bisedë bashkë me kryetarin që si do të zgjidhet pjesa e këtyre familjeve që nuk kanë dokumenta pronësie. Nuk di t'ju them, sepse duhet edhe bazuar në ligj. Pse familje të cilat nuk kanë dokumenta pronësie dhe në qoftë se ti investon pesë milionë apo dhjetë milionë lekë të vjetra. Nesër del një problem tjetër, del familja pronare e asaj shpie, sepse këto familje mund të jenë edhe familje që kanë bërë kontrata me kryepleq, kontrata me noter, të cilat nesër , ato janë të pavlefshme mbas shumë vitesh. Dhe na del që ne investojmë dhjetë milionë lekë. Nesër, pronari i shpisë e nxjerr përjashta dhe çfarë bëjmë pastaj? Krijuam një plagë tjetër shoqërore, ose sociale. Por që duhet zgjidhur, duhet zgjidhur. Nuk di çfarë them më tepër pjesën. Faleminderit.

Faslli Zholi: Do të thosha një diçka. Po, merr aty. Për shembull, po, merr konkretisht. Ne kemi një familje që e di dhe është bërë pengesë ekzekutive në dritë. Nga dusha e nga fshati im ka ardhur. Unë mendoj që ajo e ka shtëpinë atje, sepse e ka patur dem babadena. Ajo familje është

një familje shumë e varfër, me mbiemër Çela janë ata. Rrin aty, e morën atëherë në kohë që edhe fushata. Hajdeni këtej se do t'ia paguajmë qiranë. Për mua është mire të inevstojmë ta ajo shtëpi, ku është edhe ajo të jetë atje ku është në vendin e saj, që e ka shtëpinë që e ka patur dikush i atit tjetër. Dhe mbyllet kjo fletë, se ajo rri rrugëve, e shpija është rrëzuar. Ky është problemi, ky është problemi. Prandaj them që duhet të gjejmë një mekanizëm, që atë shtëpinë që ata e kanë patur historikisht, që e di unë, po marr një shembull. Plus, unë kam një kushërin tim të parë, i ka rënë shpija e fukara. Vjen ai djali me furgon tënde, është e mira ta zgjidhim këtë, i thashë dhe Andit kur bënin bënin lekalizimet, rregullimet e shpive, edhe në fshat, qoftë në Moglicë, qoftë në të gjitha gjërat që mbulojmë. Duhet të gjetur mekanizmi që këto të dokumentohen, që neve edhe t'i vijmë, se është e ligjshme që pa patur një dokument, nuk ka se si të futet as bashkia, as institucioni, askush. Sepse del ajo që thuhet, jam plotësisht dakord. Po duhet gjetur kjo, duhet pranë mendjen. Faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit, atëherë po doctor.

Yllson Ibrahimllari:Ju lutem për të mos krijuar më mjegull nga fillimi i çështjes. Nivel sqarues bisede me dashamirësinë dhe për zotërinë në fjalë. AMTP-ja nuk përmban shtëpi? Amëtëpëja shkruan troje, truall, pra nuk jep pjesën që ngrihet mbi truallin. Një kat, dy kat, se kemi dhe ish-drejtorin e hipotekës këtu dhe duhet një çik më teknikisht se sa të krijojmë mjegull, e dyta e pyetur dhe e kontrolluar te qarku, te hipoteka tjera. Fshati nga vij unë nuk ka zero zero njësh, nuk ka listë. E ka konfirmuar këtë gjë edhe njësia administrative Gorë. Velçani nuk e ka. E nderuar doktoreshë, e nderuar nënkryetar, bashkë me anëtarët e Këshillit Bashkiak. Ne kemi miratuar këtu, jo më vonë, se rreth një cikël shtatë-tetë mujor, ose po themi, t'i bëjmë dymbëdhjetë muaj. Mbi katër pesë shtëpi të djegura në mes Mesmal, në Strelcë dhe kudo tjetër, të cilat kemi ardhur dhe kemi dhënë atë, që na takon ligjërisht për një vlerësim pa çertifikatë dhe ndërkohë mos hyjmë pastaj, sepse atë e kanë bërë emergjenca dhe duket si e qëllimshme. Unë mendoj që ato pesëqind mijë lekë që i kemi dhënë asaj shpisë familjes Pillati atje me ata jetimët në Mesmal. Nuk i kanë dalë për të bërë çatinë, se edhe çatia shkatërrohet nga një djegie. Apo në Strelcë në vendin tjetër? Kjo është që neve të dokumentojmë a ka mundësi atë që kërkojmë. Vijnë shumë mirë, vijnë shumë mirë përfaqësuesit e Administratës, ne këtu nuk na vijnë as kryetarët e fshatrave, nuk na vijnë as përfaqësuesit e njësisë administrative. Le të vijë administratori i ri i njësisë administrative Gorë dhe të thotë për kë nga fshatrat e Gorës ka listë 001 që të vë me skemën e këtij zotërisë. Unë fle te shtëpia e gjyshit kur shkoj, sepse ajo shtëpia ime është e pabanueshme për arsye tjetër, mos i kalojmë tani asaj pjese, sepse del shumë individualisht. E cila kur ngjitesh në katin e dytë, tundet dhe dridhet. Ne të gjithë si trashëgimtarë të atij trungu familjar, me zë nga një i teti i po themi i nëntëdhjetë e njëshit, familja bujqësore e trajtuar me ligjin shtatë mijë e pesëqind e një, nëntëmbëdhjetë i shtati një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, jemi gatshëm të bëjmë një deklaratë që s'kemi asnjë pretendim në atë që e posedon sot, se është djali i xhaxhait tim. A futet kjo në skemën ligjërisht prej zotërisë? Pra, ne nuk i kemi këto gjëra dhe mos bëjmë sikur jetojmë në një gjë tjetër, ku të gjitha gjërat janë në rregull. Unë besoj që bashkia.Mund të përfitojë edhe shuma të mëdha ekonomike duke iu lehtësuar njerëzve barrën e pajisjes së tyre me çertifikatë. Është dhe një produkt që po sjellin, po marrin prona nga Ministria e Mbrojtjes, të cilat unë besoj që destinacionin do ta kemi në një të ardhme të shpejtë privatizimi. Është lek që vjen dhe lëviz taksat, si mbledhim dot sepse nuk kemi këtë rendiment

në mbledhje taksash. Shërbimet nuk i afrojmë dot, po si duhet të ekzistojmë? Çik urgjente, meqë është. S'dua ta zgjas më shumë këtë pjesë të asaj për të mos iu ngrënë kohë. Unë besoj që këshilli bashkiak grupit të ri për ndarjen e re Administrative, grupi mbi partizana dy palësh, si doni ta quani nga preferencat tuaja? Duhet t'i drejtojë, meqë kemi elegancën, vlerat duhet t'i drejtojë. Një komunikim dhe t'i thotë cilat janë arsyet pse ne duam që një bashkia e Maliqit të ekzistojë kështu siç është në këtë ndarje territoriale. E kemi detyrim, faleminderit.

Petrit Kupe: Kisha unë, kisha unë prapë, m më fal, po ju lutem, jam unë fjalën, të lutem.

Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli: Jo, jo, vetëm diçka, nuk është skema e zotërisë, zotëri. Është skema e Ministrisë së Financave.

Enida Avdolli: Atëherë ju lutem që mos të bëjmë mbivendosje zërash. Degjojmë z.Petrit.

Petrit Kupe: Unë e dëgjova argumentin që për herë të katërt të zotërisë. Ka një argument që mua më duket si një shenjë frike, sepse ndoshta po i bëmë çatinë Filanit erdhi Filani ia mori shpinë dhe ne do na dështojë projekti, jo. Duhet të marrë përgjegjësi për këtë punë, duhet të marrë guxim nga zyra përkatëse, nga punonjësit përkatës, nga njësia administrative, nga kryetarët e fshatrave. Që t'i bësh çatinën, atij filani që e ka në rrëzim, po s'ka ç'ka pronësie. Nuk do gënjeje as kryeplaku, nuk do gënjeje as ai përgjegjësi i administratës administrative. Nuk do të ngjejë askush që ajo shtëpi është e tija, por duhet të marrë guxim. Ky guxim mungon dhe këta njerëz do vazhdojnë të vuajnë prapë me çati të prishur. Këtë duhet të marrë bashkia, këtë duhet të lutem shumë. Ti na argumenton këtu, ti na argumenton këtu atë që po financon qeveria. Ti je në rregull, ti e morë rrogën, je në rregull. Asnjë njeri nuk ka marrë padrejtësisht. Po për ata që po rrinë pa pa rregulluar, ti ku e ke përgjegjësinë? Ti je në rregull, e firmos se këtë nuk zë SPAK. Mos ki merak. Duhet marrë iniciativa, duhet vendosur kritere, duhet vënë njerëz në përgjegjësi që ta ndjekin këtë problem dhe mbajnë përgjegjësi që ai fond që do harxhohet pranë familjes e varfëron, mos shkojë kot. Edhe nuk ka për të shkuar kot. Edhe në qoftë se ka për të shkuar kot në një pesëdhjetë familje, mund të shkojë në një. Atëherë ne nuk mund t'i lëmë të gjendet këtu. Unë do votoj gjithmonë kundra derisa të marrë zgjidhje. Kjo rrugë që propozoj nuk ka të bëj Jemi në fund të fundit, edhe ne krahët, ç'a të majtë jemi ne, ku s'mbrojmë ata që janë më të dobëtit. Kaq kishia. Faleminderit.

Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli:Më fal, mund ta ftoj këshilltarin të lexojë vetëm rreshtin e fundit të shkresës, të cilët i dhashë. Nuk dua, nuk dua me e rregulluar fare. Po të flas për punët e vet. Jo, e ftoj që ta lexoj, sepse e kaluan në personale të zyrës apo të zotërisë, siç po e citojnë dy këshilltarët dhe të zyrës që unë përfaqësoj dhe e ftoj këshilltarin që të lexojë vetëm rreshtin e fundit të shkresës. Të cilës unë i dhashë tani. Atëherë.

Petrit Kupe: Ti je punonjësi i bashkisë. Shërbimi i bashkisë nuk detyron dot mua të lexoj

Enida Avdolli: Ju lutem, një sekondë. Ju lutem, ju lutem, qetësi. Ju lutem, ju lutem.

Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli: Ja, e fundit. Pas dorëzimit të dokumentacionit, kjo është të gjithë dokumentacioni i cili dërgohet nga Ministria e Financave për financim të projekteve të cilat financon Ministria e Financave nëpërmjet buxhetit të shtetit. Dhe në termat e referencës, nuk po i lexoj të gjitha. Mund t'i vë edhe në dispozicion. Pas dorëzimit të dokumentacionit plotësues, komisioni i vlerësimit merr në vendim. Komisioni i vlerësimit është nga Ministria e Financës, nuk është nga bashkia. Merr vendim për kualifikim ose moskualifikim të projektit. Shkak për skualifikim përbën mungesa e bashkëfinancimit sipas udhëzimit numër 31.Tetëmbëdhjetë i njëmbëdhjetë i dy mijë e nëntëmbëdhjetë dhe mungesa e dokumentacionit të pronësisë. Si dhe çdo dokumentacion tjetër sipas nenit gjashtëdhjetë e nëntë të ligjit strehim, që do të thotë dokumentacioni i pronësisë është kusht për të aplikuar pranë Ministrisë së Financave për këtë lloj projekti. Faleminderit.

Enida Avdolli: Po, faleminderit për sqarimin. Atëherë, dëshirojmë të kemi ndonjë koment tjetër apo ta kalojmë tek lista? Po, zonja Alma, po.

Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka:N ë lidhje me familjet që kanë nevojë për riparim çatie, ky është komision tjetër. Unë desha të thosha diçka në lidhje me buxhetin. Dhe këto gjashtëdhjetë familje që janë këtu, dhe gjashtëdhjetë milionë lekë të reja që vete kostoja e kësaj, këto njëqind e njëzetë milionë të vjetra i përballon bashkia. Ja domethënë, vetëm për këto gjashtëdhjetë familje, si numër njëqind e njëzet milionë të vjetra, i përballon bashkia. Ja ku është ndihma e bashkisë, se këtu u fol çfarë bën bashkia për persona të tjerë, të cilët mund të jenë më nevojtarë dhe të ndryshojë ligji dhe këtë, po bashkia.

Enida Avdolli: Dakord, dakord, nuk u fol që bashkia nuk po bën gjë. U fol në lidhje me listat.

Yllson Ibrahimllari:Se jemi ndarë, jemi ndarë në dy pjesë, ne sulmuesit e bashkisë dhe bashkia në mbrojtje të saj. Ju lutem, a ka mundësi të nxjerrim diçka dhe t'ju themi administratorëve të njësisë administrative përkatëse të na sjellin ç'mendojnë ata listat e grupeve të punës të njerëzve që kanë nevojë? Se ka dokumentin, të lutem Vera, një sekondë. Nuk e ka dokumentin, sigurisht skema. I them që e përjashton skema, neve do gjejmë mundësitë e hapësirave ligjore si të përshtasim skemën me këtë gjë. Të lutem, tani ne jemi për t'iu shkuar qytetarëve. Nëse doni të çojmë qytetarin te skema, qytetari te skema shkon nga Ministria e Financave, jo nga neve. I kemi bërë këto histori në këtë këshillë. Donim të çonim lumin te harta, jo hartën te lumi. Tani mos i vazhdojmë më. Faleminderit.

Enida Avdolli: Atëherë, kemi tjetër diskutim, po zoti Andi.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula:Përshëndetje dhe një herë atëherë, meqënëse unë e kam shprehur edhe para disa muajsh. Jo vetëm për fshatra të cilët nuk kanë zero njësh, por të gjithë fshatrat të cilët kanë nevojë të paktën për asistencë ligjore. Sepse kjo është pjesa të cilën ne mund ta ofrojmë dhe pa kursim fare. Të paktën unë personalisht, së bashku edhe me Ledionin që mbulon këtë punë, meqënëse tashmë Ledioni është brenda sektorit të drejtorisë

time. Jemi të gatshëm ti sqarojmë. Unë jam dakord me të dy këshilltarët, edhe me zotin Petrit dhe me zotin Yllson, përsa i përket shqetësimit që ata kanë për të gjithë këto fshatra që nuk kanë zero njësh. Por dua t'u bëj me dije që të paktën, të paktën nga ana e qeverisë, janë miratuar dy VKM tashmë dhe është duke u miratuar edhe një VKM e tretë. Për të lehtësuar punët dhe e vetmja ndihmesë që ne mund të bëjmë si bashki është që këto VKM që janë, t'ua sqarojmë përsa i përket kostove. Individuale nuk besoj që bashkia mund ta përballojë pa dashur të marrë rolin e Almës nuk mund ta përballojë, sepse janë disa kosto të cilat nuk janë vetëm në pagesën fillestare. Por janë dhe në mbulimin me specialistë dhe me teknikë për kryerjen e këtyre regjistrimeve, gjatë të cilën bashkia nuk e ka mundësinë. Ne mund të, ose mendoj, që mund të ndikojmë. Duke ia u bërë sa më të thjeshtë pjesën e pregatitjes së dokumentacionit të gjithësecilit dhe pastaj një kontakt me zyrën e regjistrimit, besoj që mund të na mundësojë ecjen pak më shpejt të regjistrimit për këta persona të cilët janë më në nevojë. Kjo është pjesa të cilën ne mund t'ua sqarojmë. Mbase mund të bëhet dhe një ndërgjegjësim apo një ftillim i të gjithë njësive administrative nëpër fshatrat përkatëse që kanë këto problematika. Faleminderit.

Yllson Ibrahimllari:Një sqarim të vogël, ju lutem. Mundet që të bëni një urdhëresë ta paraqesni te faqja e këshillit një sqarim, siç e the zotrote, që t'ia jepni atyre administratorëve, që t'iu thoni kryepleqve, që t'i publikojnë te adresat e Facebook-ut. Nëse ngelëm me gishtin lart, duke bërë roke gjithë ditën.

Faslli Zholi: Andi, unë kam një qartësi, pa një gjë të paqartë. Kjo qeveria sot që akordon këtë shumë mirë, bën këtë tetë për qindëshin për të ndihmuar këto familje. A e di që ka iks vend, iks vend dokumenta, shpija nuk ka, dhe e vë këtë kusht, se unë e kam parë me djalin. Aty nuk ka faj, se aty na vë embargo ai. Ky është problemi që si do ta zgjidhim neve, duke i treguar asaj.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Kjo është arsyeja, kjo është arsyeja që përveç, certificates së pronësisë, ka lënë që qytetari mund të përdorë dhe formularin zero një, që është përkthimi i VKM-së 432 për listën e trojeve në fshat, apo dhe amëtëpënë, e cila ligjërisht po themi në thonjëza. Ligjërisht, nuk është e vlefshme, sepse akti i marrjes së tokës pronësi, në qoftë se ne shohim në kokën e tij, bën fjalë vetëm për pjesën e tokave bujqësore. Shumë akte e kanë të regjistruar edhe truallin. Për këtë arsye, ministria e ka parë këtë arsyeshme që mund të merret edhe ky si dokument mbështetës. Tani, në qoftë se qytetari nuk ka mundësi të aplikojë për çertifikat pronësie, nuk ka dhe aktin e marrjes së tokës në pronësi, atëherë është pak antikap,

Faslli Zholi: Nuk e bën dot, neve i themi që s'u takon as kjo. Kjo është zarar, është goditje dy herë që mund ta masakrojmë këtë familje kaq në nevojë.

Petrit Kupe:Më duket se akoma nuk po kuptojmë çfarë kërkojmë të zgjidhim. E lemë këtë vendim qeverie, e lemë këtë financim që bëhet bashkia. Këto anë që i bën qeveria. Ku është pavarësia e pushtetit lokal? Ku është? Të lutem shumë. Pushteti lokal ka dhe pavarësinë e tij. A ku është pavarësi e mësueshme lokal për të zgjidhur këtë problem? Ka ka pavarësi, ka të drejtë të përcaktojë kritere, ka të drejtë të përcaktojë rregulla, ka të drejtë të miratojë në këshillë, ka të

drejtë të vendosë dhe fond për këtë. Këtë kërkojmë ne, ajo pjesë që ka bërë ai djali e bën kushdo. Atëherë ik ti, dil përjashta. Këtë, këtë, si do ta zgjidhim? Nuk kemi të bëjmë me mendimin e qeverisë fare. Ajo është pjesa që financohet shteti. Ne çdo bëjmë, këtu është.

Përgjegjës i Sektorit të Strehimit:z.Ledion Mullalli:Më fal, mund të bëj propozim të fundit? Po. Atëherë, duke qënë se jemi në fund të kësaj, të gjithë kësaj historie, unë propozoj si përgjegjësi i zyrës së strehimit që në vitin dy mijë e njëzetë e shtatë. Të mos bëjmë aplikim pranë Ministrisë për projekt për riparimin e banesave, por atë fond të cilin ne do ta përdornim për riparimin e banesave, të gjejmë një hapësirë ligjore që atë fond ta përdorim për familjet, të cilat janë vërtetë ne i dimë, që janë vërtetë varfra dhe me banesa shumë të amortizuara, por që nuk kanë dokumenta pronësie. Por dikush duhet të marrë përsipër hapësirën ligjore që ta përdorim atë fond.

Enida Avdolli: Faleminderit, Atëherë mos të zgjat, ju lutem mos të zgjat.Po.

Yllson Ibrahimllari:Kemi një pyetje vetë. Nëse ne shkojmë në vitin kalendarik një dy mijë e njëzetë e shtatë. Nëse shkojmë në vitin kalendarik dy mijë e njëzetë e shtatë. Dy mijë e njëzet e shtatë, neve atëherësh nuk kemi mundësi juridikisht, sepse ka disa kufizime. Dy mijë e njëzet e shtata për këshillin është periudha para zgjedhore dhe nuk i ka mundësitë nëse duam të bëjmë diçka. Nuk jam kundër asaj që propozon, por jo për vitin dy mijë e njëzet e shtatë. Të shihet nëse ka mundësi brenda dy mijë e njëzet e gjashtës në gjashtë mujorin e dytë. Faleminderit. Sepse ka dhe një arsye, do vijë kryetari i bashkisë më fal dhe do thotë, nuk i bëjmë dot këto shërbime, se na i konsiderojnë në vit elektoral. Nëse s'dua të flas për njerëz që nuk janë prezent, faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit atëherë edhe një herë të gjithëve. Ju lutem, mundemi ta miratojmë listën që na ka ardhur në projektvendim? Mund ta kalojmë në votim? Atere kundër kemi një, dy, tre, katër votë, pesë vota kundër. Me pesë vota kundër, lista miratohet. Më fal, po, edhe një herë ngrem kartonat. 13 vota pro.Enida Avdolli, Ornildi Demollari, Pranvera Begolli, Floreta Zaçe, Fevri Sherifi, Kristina Malelli, Xhuana Hoxhallari, Marianthi Avarmi, Idlir Limllari, Armando Dautllari, Danjela Ibrahim, Dalina Krekas.Ju lutem, Genta, nëse do e kesh atë do e ngresh. Po, do ngresh kartonin gri. Hape po atëherë kundër.
Ju lutem, kush është kundër? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë. Fallsi Zholi, Yllson Ibrahimllari, Neresida Shindo, Server Xhuti, Petrit Kupe, Selami Muço, Gjashtë kundër.
Abstenim një? Gentiana Drabo, si përfundim miratohet. Atëherë, pika trembëdhjetë u miratua me shumicë të thjeshtë votash.Vazhdojmë tek pika katërmbëdhjetë e rendit të ditës. Projekt vendim për miratimin e planit të integritetit për Bashkinë Maliq, dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë. Lutem të flas si kryetarja e komisionit, zonja Pranvera.
Pranvera Begolli:Përshëndetje të nderuar kolegë. Aktualisht, komisioni i ligjeve dhe rregullorëve është mbledhur sot. Dhe ka diskutuar në prezencë dhe të administratës të njerëzve që punuan, të zonjës sekretare Jonila dhe të Andreas, që kanë punuar me këto. Aktualisht, ky është një plan miratimi të integritetit që ka të bëjë për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë. Është një plan që parashikon masa konkrete, afate zbërtimi, përgjegjësi, buxheti

indikativ. Që ka të bëjë me forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator, që ka të bëjë me konsolidimin e burimeve njerëzore dhe rrit që ka të bëjë dhe me rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit institucional. Por në qoftë se doni për shpjegime të tjera, nisi komision ramë dakord ta miratojmë. Nuk patëm ndonjë problem. Është prezent. Sekretarja e përgjithshme që mund të bëjë sqarimet e duhura, ju faleminderit.

Enida Avdolli: Faleminderit t'ia japim fjalën sekretares së përgjithshme, nëse ka ndonjë diçka për të shtuar.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhialli: Ky plan në fakt është vazhdimësi e planit të mëparshëm.Ne kishim planin e parë, i cili i mbaroi afati trevjeçar i zbatimit, dhe e kaluam tek plani i ri. Për miratim, ky plan u hartua me një grup pune, i cili është ka kaluar edhe këtu, me vendim Këshilli Bashkiak Grupi Punës, që është miratuar në bashkëpunim, dhe me ekspertët nga AMMV-ja. Fokusohet tek tre objektivat bazë, ashtu sikurse e tha edhe Vera, që është forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator, konsolidimi i burimit të punës dhe rritja e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit institucional. Ky plan në vetvete ka planin e veprimit me masa konkrete, që janë nxjerrë nga çdo drejtori përkatëse, të cilat do të ndiqen me afate konkrete dhe një buxhet indikativ që ka secila masë. Kemi nga plani i parë, kemi dalë një institucion me integritet të lartë, pasi janë realizuar rreth 70% të masave, 30% kanë ngelur pa realizuar dhe kanë kaluar për veprim në planin e ri. Këto masa që kanë ngelur pa realizuar në fakt kanë ndodhur për arsye e buxhetit, pasi janë plane strategjike e zhvillimit, të cilat duan një buxhet më të madh me ekspertë të jashtëm. Ndërsa masat e tjera janë realizuar. Kaq kisha, nëse ka diçka tjetër.

Enida Avdolli: Faleminderit, kemi ndonjë pyetje?

Yllson Ibrahimllari:Në mbledhjen kur kemi diskutuar projektgrupin e punës. Kemi ka qenë insistimi im që në grupin e punës të bënin pjesë edhe dy kryetarët e grupeve respektive të këshillit. Nga materialet që kemi parë, është shkëlqimi i administratës, mosprezencë e të dyja grupeve përfaqësuese. Besoj, këshilli gjithnjë është në çik më i avashët në përcaktueshmërinë e keni këtu zonjën sekretare të përgjithshme dhe të thotë ka qenë prezenca e dy këshilltarëve dhe kryetarëve të grupeve respektive në hartimin.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhialli: Jo, nga këshilltarët nuk kemi pasur asnjëherë prezent, ndaj bëmë dëgjese.

Yllson Ibrahimllari:Ju faleminderit.

Enida Avdolli: Atëherë mund ta vazhdojmë ta kalojmë në votim? E kalojmë në votim?20 vota pro.

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka. Miratohet dhe pika katërmbëdhjetë e rendit të ditës.Vazhdojmë me pikën 15 të rendit të ditës, "Për miratimin e Rregullores së brendshme për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës në bashkinë Maliq.

Pranvera Begolli:Përshëndetje përsëri, komisioni i rregilloreve dhe ligjeve u mblodh, atje u bënë pyetje nga Këshilltari z.Yllson Ibrahimllari dhe z.Petrit Kupe, ku u pyet nëse a ka patur rregullore më parë bashkia Maliq, kjo është një rregullore standarte që Sekretare e Përgjithshme do tja u shpjegojë, vjen si model nga model nga Bashkitë e Forta, është një rregullore për të gjitha bashkitë, por brenda mund të ketë dhe disa pika që nuk mund të jenë të përshtatshme për administratën tonë, kjo rregullore bëhet për herë të parë.Faleminderit!
Enida Avdolli: Faleminderit! Po.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhialli: Kjo është një rregullore standarete e cila përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e çdo niveli drejutes, ne më pare kemi funksionuar me një system pikëzimi, i cili vinte me pyejte specifike, që matete në mënyrë sasiore dhe cilësore çdo indikator, ju shpërndahej drejtorive përaktëse, mblidheshe informacioni dhe dërgohej te AMMV-ja ku krijohej raporti përfundimtar i perforamancës dhe publikoj në faqen e bashkisë.Sot hartojmë këtë rregullore dhe e kemi detyrim ligjor, për arsye sepse këtu ndahne qartë përgjegjësitë të të gjitha niveleve drejtuese se çfarë duhet të bëjnë në raportin e performances, gjithashtu një pika tjetër shumë e rëndësishme, që ne duhet të fitojmë dhe Grandin me bazë performance.

Enida Avdolli: Faleminderit!Atëherë, peytje tjetër? E kalojmë në votim? 20 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.Miratohet dhe pika 15 e rendit të ditës, tani te diskutime ashtu si ramë dakord në fillim të mbeldhjes për të shtuar dhe një P-V që ju e keni marrë si material dhe dua tju njoftoj që pasi të mbarojmë me mbledhjen e Këshillit, nuk duhet të largohemi nga salla sepse mbeldhja do të vazhdojë për të diskutar në P-V të "Kombinatit të Sheqerit Maliq" .Vazhdojmë me P-V "Për fillimin e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike në fshatin Vashtmi të Bashkisë Maliq"; Kmei diçka në lidhje me këtë P-V? Atëhere z.Andi keni ju diçka?
Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula: Atëherë, ashtu si jeni në djeni nga materiali që ju është dorzuar, ju kërkojmë ndjesë që u fut në momentin e fundit, por duke kaluar një sërë fshatrash para disa muajsh e pamë të aryeshme dhe ishte shumë e ngutshme dhe zgjerimi i varrezave të fashatit Vashtëmi, e cila po bëhet një pike shumë e plotësuar dhe kërkohe një sipërfaqe shtesë, ng ana e drejorisë tone janë marrë të gjitha masat u konsultuma dhe me banorë të fshatit dhe me Kryetarin e fshatit për të gjetur një mundësi dhë për ta përshtatur sa më mire, kjo ka qenë arsyeja e vonesës dhe dorzimit në momentin e fundit.Nga pjesa që ne duam të zgjerojmë preken rreth 11 pasuri dhe do jetë në pjesën perëndimore të varrëzeva që janë aktualisht, kemi përgatitur dhe materailin jo vetëm të shpronësim,it por dhe pjsën e rrethimit për varrezat shut si e ka të përcaktuar edhe ligji në mënyrë që të hapet drita jeshile që edhe atje mos ketë probleme.
Enida Avdolli: Faleminderit për saqrimin!

Yllson Ibrahimllari:Ju lutem pse evidentoni që materiali ka erdhur me vonesë duke na kërakur dhe ndjesë publike, kur materiali mban të njëjtën datë si të gjitha P-V e tjera 19.02.2026 thjes ka

ardhur në e-mail me vonesë, jo se ka ngërç afati ligjor që ne nuk na ka ardhur ose është e vënë e njëjta date dhe kjo nuk është shumë e ndreshme në raport me njëri-tjetrin.Ne dakord jemi ta miratojmë.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve;z.Johand Sula:T'ju saqroj doktor.Pjesa e ndjesës është sepese material nga ligjore, për sa i përket anës grafike, kjo ishte pjesa e cila na vonoi, për pozicionimin e e këtyre sipërfaqeve shtesë.

Yllson Ibrahimllari:Po pra, por juridhikisht mban të njëjtën date si P-V e tjera.Nuk kemi një ngërç jurdik, është një vonesë që ka ardhur dhe tani besoj dhe varrezat janë emergjncë si gjithë emergjenacat e tjera, ose e keni bërë në date 27 dhe e keni vënë datën 19.Këtë duhet ta thoni ju si zyrë, nuk është e mire me ne se nuk ju kemi vënë ndonjë pengesë.Pastaj thoni rrëmoni doktori, nuk kam çfarë të bëj që jam me syze.

Enida Avdolli: Faleminderit! Jemi dakord ta kalojmë në votim? Kush është dakord? 20 vota pro. Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.Miratohet.Kemi diçka tjetër te diskutime të tjera? Këtu mbyllet mbeldhja e Këshillit dhe vazhdojmë me mbeldhjen e Asamblësë të Kombinatit të Sheqerit Maliq.Ju falmeminderit! Kjo ishte mbeldhja.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ